



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.723/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Hajriz Hoti, e me procesmbajtëse Kaltrina Çitaku, në konfliktin administrativ të paditësit, Xh.R., nga F.1, kundër të paditurve, Komuna e F.2, të cilën e autorizime përfaqëson S.V. dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Prishtinë, cilin me autorizim e përfaqëson, Z.G., Zyrtare Ligjore, për shkak të anulimit të vendimit dhe pagimin e pagave për përcjellje në pension, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të palëve, me dt.23.08.2018, merr këtë,

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit, Xh.R. nga F.1. Anullohet vendimi i të paditurit, Këshilli të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në Prishtinë, me nr. A/02/36/2017, i dt.13.03.2017 dhe vendimi i Komunës së F.2 i dt.10.01.2017, si dhe detyrohet e paditura, Komuna e F.2 që paditësit, Xh.R. në emër të përcjelljes në pension, t'ia paguaj dy paga në shumën prej 865.18 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi, nën pasojat e ekzekutimit me detyrim.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi, Xh.R. në seancë e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe i ka propozuar Gjykatës që vendimi i të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Prishtinë dt.13.03.2017 dhe vendimi i Komunës së F.2 dt.10.01.2017, të anulohen në tërësi si kundërligjshëm si dhe të detyrohet e paditura, Komuna e F.2 që t'ia paguaj dy paga për përcjellje në pension në lartësi prej 865.8 euro. Me tutje ka shtuar se një pagë i'a ka paguar e paditura Komuna e F.2, për këtë arsye me padi kërkon pagesën edhe të dy paga tjera të papaguara, për përcjellje në pension.

E autorizuara e të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar dhe mbetet pranë përgjigjes në padi të dt.14.02.2018 dhe i ka propozuar Gjykatës që të vërtetoj vendimin e këshillit të bazuar dhe të ligjshëm.

I autorizuari i të paditurës, Komuna e F.2, S.V. në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetem në tërësi sikur në seancën e mëparshme duke kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, ngase nga të gjitha provat që ekzistojnë në lëndë është konstatuar se, Komuna e F.2 në bazë të dispozitave të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil dhe të Rregullores 33/2012 i ka permbushur detyrimet për paditësin. Pretendimet e paditësit që duhet ti gëzon tri paga jubilarë në baze të kontratës kolektive, konsidërojmë se dispozitat e Kontratës Kolektive të dt.18.03.2014 janë në kundërshtim të plotë dhe në kolizion me dispozitën e nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe të Rregullorës 33/12 për Shtesa në Page dhe Kompezime Tjera të Nëpunësve Civil. është e pa mohueshme se kjo rregullore ende është në fuqi dhe prodhon efekte juridike, gjë që të gjitha të drejtat që burojnë nga kjo Rregullore kanë efektet të natyrës detyruese.

E autorizuara e të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit si të pa

bazuar dhe mbetet pranë përgjigjes në padi të dt.14.02.2018 dhe i ka propozuar Gjykatës që të vërtetoj vendimin e këshillit të bazuar dhe të ligjshëm.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.23.08.2018, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi i KPMK dt.13.03.2013, vendimi i KK F.2 dt.10.01.2017, ankesa e paditesit dt.09.12.2016, përgjigje në ankese dt.14.02.2017, kërkesa për pagesa retroaktive nga Komuna F.2 dt.09.12.2016 si dhe vendimi për perfundimin e e madhenjes se punes per paditesit dt.27.11.2016.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në përputhje me nenin 46.4 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Prishtinë, me nr. A/02/36/2017, i dt.13.03.2017, i padituri ka refuzuar ankesën e paditësit si të pa bazuar, ndërsa vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve të Komunës të Ferizajt të dt.10.01.2016 e ka lënë në fuqi.

Paditësi e pakënaqur me këto vendime, ka ushtruar padi në këtë gjykatë me dt.20.04.2017, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Nga vendimet e kontestuar del se ato përmbajnë të meta të tilla për shkak të te cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par.2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar.

Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërbërës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar.

Në arsyetimin e vendimeve është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt, ku thuhet se, “Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore te ankuesit i cili pretendon se organi i punësimit duhet të bëjë pagesën në vlerë të tri (3) pagave me rastin e pensionimit ashtu siç parashihet me “Marrëveshjen Kolektive”, dhe ka konstatuar se pretendimet ankimore te ankuesit janë të pa bazuara, sepse për kompenzimet e nëpunësve civil janë të aplikueshëm dispozitat e Ligjit nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe aktet e tjera nënligjore për zbatimin e këtij ligji dhe në bazë të këtij ligji nëpunësve civil në rastin e pensionimit ju takon kompenzimi në vlerë të një page të njëhershme, e jo të tre pagave siç ankuesi pretendon kjo parashihet me nenin 22 të Ligjit nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe dispozitat e nenit 19 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores 33/12 për Shtesa në Page dhe Kompenzime Tjera të Nëpunësve Civil i cili përcakton se: paragrafi 1. sipas ligjit nëpunësit civil, që arrin moshën e pensionimit në shërbimin civil, gëzon të drejtën e kompenzimit dhe paragrafi 2. Nëpunësi civil që arrin moshën e pensionimit, gozën të drejtën e marrjes së një pagesë në shumën e një (1) pagë mujore të njëjpasnjëshme në vlerën e pagës së fundit”.

Nga ky arsyetim i vendimit kontestues, gjykata nuk mund të kuptoj se pse këtu paditësit nuk i takon e drejta e përcaktuar nga Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive, kjo për faktin se njëjta marrëveshje është në fuqi që nga data;01.01.2015 dhe së e njëjta Marrëveshje e Përgjithshme Kolektive është nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht kryeministri i saj,

e cila duke u bazuar në nenin 6 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës e Administron Shërbimin Civil të Kosovës. Ku në nenin 53 të te njëjtës i punësuari në rastin e pensionimit gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi të tri (3) paga mujore, që i ka marrë për tre muajt e fundit. Krejt kjo për faktin së dispozitat e kësaj marrëveshje obligojnë palët e kësaj marrëveshje në sektorin privat, publik dhe shtetëror (në nivel të përgjithshëm në nivel të degëve dhe në nivel ndërmarrjeje), e përcaktuar me nenin 2 të te njëjtës. Gjithashtu kjo marrëveshje sipas nenit 3 aplikohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe nuk mund te përbeje përjashtim për rastin e paditësit.

Sipas vlerësimit të gjykatës pretendimi i të paditurit në arsyetimin e vendimit kontestues se nëpunësit civil i takon vetëm një pagë në bazë të Ligjit për Pagat e Nëpunësve civil dhe të Rregullores 33/2012 për Shtesa në Page dhe Kompenzime Tjera të Nëpunësve Civil, është i pa bazuar për faktin se, Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, është ligj për palët nënshkruese me të cilën përfaqësuesit e punëdhënësve dhe përfaqësuesit e të punësuarve ka marrë te drejta dhe detyrime shtese në raport me ligjet ekzistuese, të cilat i rregullojnë marrëdhëniet e punës në sektorin publik-shtetëror dhe privat dhe si e tillë, kjo marrëveshje duhet edhe të zbatohet.

Me vendimin e lëshuar nga Komuna e F.2 të dt.27.11.2016, gjykata vërteton se paditësit, i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, ndërsa me vendimin e dt.10.01.2017, paditësi nga Komuna e F.2 i është njohur e drejtë në një pagë me rastin e pensionimit në shumë prej 432.59 euro. Ndërsa me vendimin e po të njëjtës dt.10.01.2017, paditësit i është refuzuar ankesa e dt.09.12.2017, për pagesën e tre pagave me rastin e pensionimit.

Lidhur me lartësinë e pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, gjykata u bazua në ne listën e pagave të lëshuar nga Komuna e F.2, të dt.09.12.2016, në të cilën figuron se paditësi pagën e fundit, para pensionimit e ka pasur në shume prej 432.59 euro.

Mbi këto arsye Gjykata i anulon vendimet e kontestuar nga paditësi si të kundërligjshme dhe paditësit ia njehë të drejtën në pagesën e dy pagave përcjellëse në pension në bazë të dispozitave të sipërcituara të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të Ligjit për konfliktet Administrative, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna me lart, gjykata në kuptim të nenit 46.4, lidhur me nenet 5, 6, dhe 38 Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr.723/2017, dt.23.08.2018,

Procesmbajtese
Kaltrina Çitaku

G j y q t a r
Hajriz Hoti

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.